



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

Nr. 14-316/05-44568/26, më 27 MAR 2026

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.nr.110 – 391, të dt. 25.02.2010 dhe Ligjit nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**URDHËRESË**

1. NDALOHET qarkullimi i të gjitha mjeteve bujqësore në rrugët publike të zonave urbane të Kryeqytetit.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, mjete bujqësore konsiderohen:
  - Motokultivatorët/multikultivatorët;
  - Makineritë e tjera të destinuara për punë bujqësore.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Policia e Kosovës dhe Inspektorati komunal ku shkeljet e kësaj urdhërese do të sanksionohen në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, legjislacionin tjetër në fuqi dhe rregulloret komunale.
4. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
5. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

**U DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

